



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:114320

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05656974

**PKR.nr.347/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i Trupit Gjykes Alban Ajvazi, si dhe me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leutrim Hoti, në çështjen penale të pandehurve: A.H, I.SH, A.M, E.H, D.F-P dhe I.A, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.484/20 të datës 09.06.2021, konform dispozitave të nenit 287 par.1 të KPPRK-së dhe nenit 357 par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së, me datë 07.05.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**HEDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.484/20 të datës 09.06.2021.

**PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurve:

**I. A.H**, nga i ati Sh. dhe e Xh., e gjinisë Sh., i lindur më datë ..., në ..., komuna Podujevë, me vendbanim në ..., në Podujevë, me nr. personal ..., i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**II. I.SH**, nga i ati R. dhe e ëma S.1, e gjinisë S.2, e lindur më ..., në Podujevë, ku edhe jeton në ..., ka të kryer fakultetin, me profesion profesorëshë, me nr. personal ..., e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

**III. A.M**, nga i ati I. dhe e ëma R., e gjinisë Z., i lindur më datë ..., në Podujevë, ku edhe jeton në ..., me nr. personal ..., i martuar, ka të kryer shkollimin e lartë, me profesion teknik i farmacisë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

**IV. E.H**, nga i ati M. dhe e ëma B., e gjinisë Z., i lindur më ..., në Podujevë, ku edhe jeton në ..., me nr. personal ..., i martuar, ka të kryer shkollimin e lartë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**V. D.F-P**, nga i ati A. dhe e ëma F., e gjinisë A., e lindur më ..., në Podujevë, me adresë banimi në ..., në ..., në Podujevë, me nr. personal ..., e martuar, studente, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

**VI. I.A**, nga i ati Xh. dhe e ëma S., e gjinisë A., e lindur më ..., në Podujevë, ku edhe jeton në ..., nr. 608, me nr. personal ..., e pa martuar, ka të kryer fakultetin e Inxhinierisë, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

*- Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.*

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë nën shenjën PP.I.nr.484/20 të datës 09.06.2021, kundër të pandehurve: A.H, I.SH, A.M, E.H, D.F-P dhe I.A për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata me datën 08.07.2022 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën të pandehurit ishin deklaruar të pa fajshëm për veprën penale e cila i vihet në barrë, me ç'rast gjykata i ka udhëzuar të njëjtit që brenda afatit prej 30 ditësh të paraqesin: çdo kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë dhe çdo kërkesë për hedhje të aktakuzës.

Të pandehurit nuk kanë paraqitur kërkesë për kundërshtim të provave dhe kërkesë për hedhje të aktakuzës.

Prokurori i shtetit Bashkim Zeqaj para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, me parashtresën e datës 26.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se tërhiqet nga ndjekja penale, ndaj të pandehurve: A.H, I.SH, A.M, E.H, D.F-P dhe I.A në drejtim të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak se është krijuar praktika gjyqësore që në raste të njëjta penale aktakuza është refuzuar ose është marr aktgjykim lirues nga gjykata si dhe duke pas parasysh dashjen të pandehurve si element parësor i kryerjes së veprës penale.

Gjykata pas tërheqjes së prokurorit të shtetit nga ndjekja e penale për të pandehurit, analizimit të shkresave të lëndës dhe analizimit të bazës ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me këtë dispozitivë ligjore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës, u mor në bazë të nenit 453 par.1 të KPRK-së.

Nga sa u tha më larte në bazë të nenit 287 par.1 të KPRK-së dhe nenit 357 par.1, nënpar.1.3 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**

**PKR.nr.347/21, datë 07.05.2024**

**Kryetari i Trupit Gjykes - Gjyqtari**  
Alban Ajvazi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa dhe mund të ushtrohet nga palët e pa kënaqura brenda pesë (5) ditëve, nga dita e pranimit, përmes kësaj gjykate, duke ju drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë.